



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:001826

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06035663

C.nr.1611/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësve I.H, J.K, A.R, të gjithë nga Rahoveci, mësimdhënës në SH.F.M.U. “Bekim Sylka” në Rahovec, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati Z.H, nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Prishtinë, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e objektit të kontestit 1,818.72 euro, jashtë seance me datë 09.08.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve I.H, J.K, A.R, të gjithë nga Rahoveci.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses I.H, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.12.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses J.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.12.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A.R, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022 në shumën prej 522.54 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 28.12.2023, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

V. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses së parë I.H për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 606.24 euro e deri në shumën prej 522.54 euro dhe atë për shumën prej 83.70 euro, paditëses së dytë J.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 606.24 euro e deri në shumën prej 522.54 euro dhe atë për shumën prej 83.70 euro dhe paditëses së tretë A.R për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 606.24 euro e deri në shumën prej 522.54 euro dhe atë për shumën prej 83.70 euro.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve ti paguaj shumën prej 238.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësit I.H, J.K, A.R, të gjithë nga Rahoveci, përmes të autorizuarit të tyre Z.H, avokat në Prishtinë, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe 10.11.2022 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhen të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor, për periudhën kohore nga data 01.01.2022 e deri me datën 31.12.2022, për 12 muaj, secilit paditës t'ia paguajë shumën prej 606.24 Euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 238.00 euro.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 30.07.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Paditësit kanë ushtruar padi në gjykatë më 28.12.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e përqindjes së inflacionit, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2022, me mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021. Kërkesëpadinë e paditësve e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Paditësit kanë parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 10.02.2022, andaj konsiderojmë që kërkesëpadia e paditësve është parashkruar në tërësi ngase nga hyrja në fuqi e KKAK, të datës 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në këtë gjykatë kanë kaluar më shume se 3 vite. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësit të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e

Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Bekim Sylka” në Rahovec. Komuna e Rahovecit, si mësimdhënësi të ciklit të ulët. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës të datës 31.05.2021 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve I.H, dhe A.R, e që është shuma prej 421.00 euro. Ndërsa paditësja J.K, ka pagën bazë 434.00 €. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për paditësit I.H, J.K, A.R, dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për periudhën Janar- 21 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.54 € euro ($421 * 11.6\% = 48.83 * 10 = 488.36$ €). $48.83 \div 30 = 1.62 * 21$ ditë $= 34.18 + 488.36 = 522.54$ €.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (datë e parashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata në këtë çështje kontestimore ka vërtetuar faktin se paditësja J.K kishte pagën bazë në shumë prej 434.00 euro, fakti i vërtetuar sipas listës së pagës së paditëses. Paditësja në kërkesëpadinë ka kërkuar në bazë të pagës në shumën 421.00 euro. Në Ligjin për Procedurën

Kontestimore neni 2 par. 1 përcaktohet “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”. Mirëpo, në rastin konkret paditësja sipas kërkesëpadisë ka kërkuar kompensimin në emër të inflacionit shumë më si në aktgjykim, ndërsa kjo kërkesë e saj është brenda kufijve të kërkesës, gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur ta refuzojë si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë si në pikën V. të dispozitivit paditëses së parë I.H për pjesën tjetër të padisë mbi shumë prej 606.24 euro e deri në shumë prej 522.54 euro dhe atë për shumë prej 83.70 euro. Paditëses së dytë J.K për pjesën tjetër të padisë mbi shumë prej 606.24 euro e deri në shumë prej 522.54 euro dhe atë për shumë prej 83.70 euro. Paditëses së tretë A.R për pjesën tjetër të padisë mbi shumë prej 606.24 euro e deri në shumë prej 522.54 euro dhe atë për shumë prej 83.70 euro, pasi që gjykata vlerëson se në rastin konkret bazuar në *Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve*” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duhet të llogaritet në bazë të pagës bazë 421.00 €, e jo siç kanë kërkuar paditësit në bazë të pagës neto për paditësit.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë të paditësit, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.*”

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “*Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura*”.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 238.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 208.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 30.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.1611/2023, më datën 09.08.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Omega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.